

VENDIM
Nr.576, datë 8.12.1999

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.129, DATË 18.3.1999, “PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 19 dhe 21, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.129, datë 18.3.1999 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

“Në Kreun IV
Kushtet për pajisjen me leje tregtimi

a)Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“Kapitali minimal që duhet të ketë një shoqëri anonime në llogarinë e saj në bankë, në çastin e kërkesës për pajisje me leje tregtimi, të jetë:

-Për lejet e tregtimit të llojit “A”	30 000 000 lekë
-Për lejet e tregtimit të llojit “B”	5 000 000 lekë
-Për lejet e tregtimit të llojit “C”	10 000 000 lekë

b)Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Për subjektet që tregtojnë vajra lubrifikantë, kapitali minimal i shoqërisë anonime në llogarinë e saj në bankë, në çastin e paraqitjes së kërkesës për pajisje me leje tregtimi të llojit “A”, për kategorinë IV-A (zëri “Vajra lubrifikantë”) të jetë 2 000 000 lekë;

c)Pika 2 të ndryshohet si më poshtë:

-Për lejet e tregtimit të llojit “A” kapaciteti minimal i depozitave të jetë 3 000 m3

Depozitat, kur leja është e llojit “A”, për disa kategori produktesh, duhet të jenë të ndara nga njera-tjetra.

-Për lejet e tregtimit të llojit “A”, kategoria IV-A (zëri “Vajra lubrifikantë”) kapaciteti magazinues i mbuluar të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 100 m2.

Për lejet e tregtimit të llojit “B”, impiantet e depozitimit të gazit të jenë me kapacitet të instaluar jo më të vogël se 200 m3.

Implantet e depozitimit mund të jenë edhe më shumë se një, por me kusht që secili të plotësojë normat teknike, të përcaktuara në urdhrin e ministrit përkatës.

-Për lejet e tregtimit të llojit “C”

Kur leja jepet për produkte të kategorisë II/b, kapaciteti të jetë jo më i vogël se 100 m3.

Kur leja jepet për produkt të kategorisë III/c, kapaciteti të jetë jo më i vogël se 500 m3.

Ç) Fjala e parë e pikës 3, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.129, datë 18.3.1999 të riformulohet si vijon:

“Shoqëritë anonime, që kërkojnë të marrin leje tregtimi, duhet të kenë në pronësi ose në përdorim të tyre, në çastin e kërkesës për leje dhe gjatë gjithë kohës së veprimtarisë, jo më pak se 2 mjete transportuese për naftë, gaz apo nënprodukte të tyre, me një kapacitet të përgjithshëm jo më të vogël se 25 ton”.

d)Në fund të pikës 7 të vendimit të sipërpërmendur shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Për subjektet që kërkojnë të pajisen me leje tregtimi të llojit “B” (zëri “gaz i lëngshëm”) plotësimi i kushtit të kapacitetit minimal të bëhet brenda datës 1.5.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta